



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 146, datë 30.08.2021

**PËR
MIRATIMIN E SHOQËRISË AUDITUESE “GRANT THORNTON” SH.P.K., PËR
AUDITIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE
“WVP FUND MANAGEMENT TIRANA” SH.A. SI DHE TË FONDEVE QË
ADMINISTROHEN PREJ SAJ**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 35, të Ligjit nr. 56/2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive”, si dhe të Rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të SHAFP dhe SIK”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e shoqërisë audituese “Grant Thornton” sh.p.k., për auditimin e pasqyrave financiare të shoqërisë administruese “WVP Fund Management Tirana” sh.a. si dhe të fondeve që administrohen prej saj, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2021.**
- 2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Kapitaleve dhe Fondeve, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**